



REPUBLIKA E SHqipërisë
MINISTRIA E FINANCAVE

Shkurt 2016

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujo

Mars

Prill

Maj

Qershor

Korrik

Gusht

Shtator

Tetor

Nëntor

Dhjetor

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Shkurt 2016

© Ministria e Financave, 2016

Drejtoria e Makroekonomisë dhe Statistikave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë

www.financa.gov.al

E-mail: marsed.harizi@financa.gov.al
eva.doda@financa.gov.al

Përmbajtja

VEÇORITË KRYESORE	2
ZHVILLIMET EKONOMIKE	3
1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit	3
2. Kursi Mesatar i Këmbimit	4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave	5
4. Bilanci i Pagesave	6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar	7
6. Kredia për Ekonominë	8
7. Oferta e Parasë	9
8. Depozitat sipas Burimeve	10
SEKTORI FISKAL	11
1. Buxheti i Konsoliduar	11
2. Të Ardhurat sipas Burimeve	12
ANEKSI STATISTIKOR	13

Veçoritë Kryesore

- *Indeksi i çmimeve të konsumit* në muajin shkurt 2016 arriti në 102.01 për qind;
- *Norma vjetore e inflacionit* për muajin shkurt 2016 ishte 0.2 për qind;
- *Kursi mesatar i këmbimit të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja* për muajin shkurt 2016 ishte 124.7 lekë për dollarë dhe 138.3 lekë për euro;
- *Normat e interesit të depozitave në lekë* gjatë muajit shkurt 2016 shënuan kuotat 1.15 për qind për ato 12-mujore, 0.74 për qind për 6-mujoret ,0.51 për qind për depozitat 3-mujore dhe 0.56 për qind për depozitat 1-mujore;
- *Normat e interesit për huatë në lekë* ishin 7.31 për qind për huatë 12-mujore dhe 9.48 për ato 6-mujore;
- *Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3*, arriti në 1,206,208 milionë lekë në muajin shkurt, duke shënuar një rritje prej rreth 1.2 për qind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- *Bilanci i përgjithshëm pagesave* për tremujorin e katërt të 2015-ës shënoi rritje të mjeteve valutore (rezervës), pra suficit, me rreth 169 milionë euro;
- *Situata Buxhetore* për periudhën janar-shkurt 2016 rezultoi me një suficit të përgjithshëm prej rreth 10.3 miliardë lekë, që do të thotë se janë mbledhur rreth 9.2 miliardë lekë më shumë se planifikimi për këtë periudhë (ndërkohë që suficiti ishte planifikuar 1.1 miliardë lekë).
- *Të ardhurat* gjithsej të realizuara gjatë periudhës janar-shkurt 2016, arritën në rreth 61.7 miliardë lekë ose afërsisht 103.4 për qind e planit për periudhën dymujore.
- *Shpenzimet* gjithsej gjatë të njëjtës periudhë, arritën në rreth 51.4 miliardë lekë ose 87 për qind e shpenzimeve të planifikuara për periudhën janar-shkurt.


Zhvillimet Ekonomike

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Inflacioni vjetor për muajin shkurt 2016 ishte +0.2 %. Një vit më parë ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit ishte 2.3 %.

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) për muajin shkurt 2016 shënoi rritje prej 1.1 për qind krahasuar me muajin janar 2016. Ky indeks ka shënuar rritje prej 0.9 dhe 0.6 për qind edhe gjatë muajit janar 2016 dhe dhjetor 2015 krahasuar me muajin paraardhës. Ndryshimet respektive me të njëjtët muaj të një viti më parë, kanë shënuar rritje me 2.4 për qind për muajin shkurt 2015, rritje me 1.4 për qind për muajin janar 2015 dhe rritje me 0.7 për qind për muajin dhjetor të vitit 2015.

Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, ato të cilët patën kontributin më të lartë në inflacionin e përgjithshëm ishin: “Ushqime dhe pije jo alkoolike” me një rritje vjetore të çmimit prej +2.2%, duke kontribuar me +0.78 pikë përqindje; “Shërbimi arsimor” me një rritje vjetore të çmimit prej +4.8%, duke kontribuar me +0.19 pikë përqindje dhe “Pije alkoolike dhe duhan” me një rritje vjetore të çmimit prej +2.6%, duke kontribuar me +0.13 pikë përqindje. Rënia më e madhe gjatë muajit shkurt u konstatua në kategorinë “Transport” dhe “Veshje dhe këpucë” me rënie përkatësisht -4.1 dhe -3.4 për qind. Pësha specifike që zënë



këto grupe në shportën e mallrave të konsumit, bën që ndryshimet e çmimeve për këto grupe të kenë efekt mbi normën e inflacionit me nga -0.26 dhe -0.14 pikë përqindje.

Krahasuar me muajin Janar 2016, rritja më e madhe mujore e çmimeve vërehet në grupin “Ushqime dhe pije alkoolike” me 3,3 %. Ulja më e madhe mujore e çmimeve vërehet në grupin “Veshje dhe këpucë” me 1,3 %.

Ndryshimet vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit, në përqindje, për vitin 2015 dhe për periudhën shkurt 2016 paraqiten në tabelën 1. Ndryshimi mujor i indeksit është 1,1 %.

Tab - 1 Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)


VITI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
2015	1.3	2.3	2.2	2.3	1.8	1.4	1.3	1.9	2.2	2.1	2.1	2.0
2016	1.5	0.2										

Burimi: INSTAT

2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin shkurt 2016, arriti në 138.33 lekë/euro, duke shënuar rënie në vlerë me -0.01 për qind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit shkurt, një euro u këmbye me 138.24 lekë. Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin shkurt 2016 arriti në 124.69 lekë/dollarë duke shënuar rënie me -2.1 për qind kundrejt muajit janar 2016. Në fund të muajit shkurt, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 126.59 lekë/dollarë.

Fig-2



Ecuria e Kursit të Këmbimit gjatë muajit shkurt 2016

Burimi: Banka e Shqipërisë

Në krahasim me muajin shkurt të vitit të kaluar, rezulton se monedha shqiptare është mbiçmuar (mesatarisht) ndaj dollarit amerikan në masën 1.0 për qind, ndërsa kundrejt monedhës evropiane rezulton se është nënçmuar në masën -1.35 për qind. Nënçmimi i lekut kundrejt monedhës evropiane dhe mbiçmimi ndaj monedhës amerikane, është i lidhur me ecurinë e tyre në tregjet monetare ndërkombëtare, duke reflektuar sjelljen e tyre në tregun e brendshëm monetar.

Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan, pësoi një rritje mesatar rreth 0.901 dollarë/euro. Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë këtij muaji përmendim: ruajtja e ritmeve pozitive të rritjes ekonomike në vend, efikasiteti i politikës fiskale, efikasitet në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë, etj.



3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit shkurt 2016, normat e interesit të depozitave 12 dhe 6-mujore në lekë arritën kuotën e 1.15 dhe 0.74 për qind duke shënuar respektivisht rënie prej -0.03 dhe -0.16 pikë përqindje krahasuar me muajin janar 2016. Rënie për këtë muaj kanë shënuar edhe normat e interesit të depozitave me afat të maturimit 3-mujore dhe 1- mujore duke arritur respektivisht në nivelin 0.51 dhe 0.56.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, rënie kanë pësuar të gjitha normat e interesit të depozitave me afat maturimi 12, 6, 3 dhe 1-mujore. Rënia më e madhe prej -0.95 pikë përqindje është shënuar nga depozitat me afat të maturimit 1- mujor që kanë arritur nivelin 0.56 për qind për shkurt 2016.

Interesi i huave 12-mujore gjatë muajit shkurt 2016 shënoi rënie me 0.98 pikë përqindje, duke arritur në nivelin 7.31 për qind krahasuar me muajin janar 2016. Ndërsa, norma e interesit të huave 6-mujore për këtë muaj shënoi rritje me 0.24 pikë përqindje krahasuar me një muaj më parë duke arritur nivelin 9.48 për qind.

Normat e interesit të bonove të thesarit gjatë muajit shkurt 2016, për bonot 12 dhe 6-mujore ishin përkatësisht 1.78 dhe 1.36 për qind. Gjatë këtij muaji, vihet re rënie në *yield*-in e këtyre bonove të thesarit përkatësisht me -0.32 dhe -0.63 pikë përqindje.




4. Bilanci i Pagesave

Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e katërt të vitit 2015 shënoi rritje të mjetëve valutore, pra suficit, me rreth 169 milionë euro. Tremujori i fundit i 2015-ës u mbyll me një deficit të llogarisë korrente prej 413 milionë euro, me një rritje prej 8% kundrejt tremujorit të katërt të vitit 2014. Në krahasim me një vit më parë, deficitin e tregtisë së mallrave u rrit me 7% duke arritur në 705 milionë euro. Flukset e kapitalit, shumat e tepërimit nën zërin “Llogaria kapitale” dhe “Llogaria financiare”, regjistruan një pozicion neto pozitiv prej rreth 493 milionë euro dhe kanë mundur plotësisht financimin e deficitit korrent. Karakteristika strukturore e Bilancit të Pagesave paraqitet në figurën 5.

Llogaria korrente për tremujorin e katërt të vitit 2015 thelloi deficitin e saj në rreth 1,155 milionë euro nga 1287.1 milionë euro që rezultonte në vitin 2014. Ky efekt negativ i llogarisë korrente në balancin e pagesave është kompensuar nga përmirësimi i vazhdueshëm i llogarisë financiare dhe kapitale, e cila regjistroi një rritje me 32.4% për tremujorin e katër 2015, kundrejt tremujorit të katërt 2014. Kompozicioni i llogarisë korrente prej -413.7 milionë euro është shprehur sipas elementeve kryesorë përbërës (në terma neto) për vitin 2015:


- (i) bilanci tregtar me -705.4 milionë euro,
- (ii) shërbime neto me 141.2 milionë euro,
- (iii) të ardhura neto me 50.3 milionë euro,
- (iv) transfertat neto me 201.0 milionë euro.

Kjo strukturë në mënyrë vizuale paraqitet në figurën 6.



Bilanci i Pagesave per T4-2015

Burimi: Banka e Shqipërisë



Llogaria Korrente per T4-2015



Burimi: Banka e Shqipërisë

5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit shkurt 2016, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N), me rreth 77,779.2 miliardë lekë krahasuar me muajin shkurt të vitit 2015. Kjo rritje ka ardhur më së shumti si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto të Bankës së Shqipërisë me rreth 46,798.2 miliardë lekë dhe të bankave të nivelit të dytë me rreth 30,981.0 miliardë lekë dhe të rritjes së mjeteve valutore neto.

Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në 1,206,208.0 milionë lekë në muajin shkurt, duke shënuar rritje prej rreth 1.2 për qind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Në muajin shkurt 2016, sistemi bankar rezulton me një rënie prej -89.1 miliardë lekë në mjetet valutore neto, krahasuar me muajin janar 2015. Rënia për këtë muaj, krahasuar me muajin paraardhës ka ardhur kryesisht si pasojë e rënies mujore së mjeteve valutore neto të Bankës së Shqipërisë me -9,310.8 miliardë lekë.





6. Kredia për Ekonominë

Totali i kredisë për ekonominë për muajin shkurt 2016 arriti në 544,355.5 miliardë lekë. Teprica e kredisë, krahasuar me muajin shkurt 2015 shënoi rënie me vlerë -12,344 miliardë lekë, pra rënie prej rreth -2.2 për qind. Struktura e tepricës së kredisë sipas monedhave mbizotërohet nga kredia në valutë, duke përbërë rreth 56.2 për qind të totalit të tepricës së kredisë me rreth 305,979 milionë lekë.

Gjatë muajit shkurt 2016, zëri “Korporata jofinanciare private”, zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 64.9 për qind ose 353,463 milionë lekë, ndjekur nga kreditë për individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin 28.22 për qind ose 153,639 milionë lekë. Zërat “Korporata jofinanciare publike” dhe “Korporata të tjera financiare” arritën respektivisht 5.07 dhe 1.61 për qind apo 27,612 dhe 8,763 milionë lekë.


Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës për muajin shkurt 2015, zëri “Korporata private jofinanciare” zuri peshën më të lartë të kredive në lekë, me rreth 53.48 për qind, ndjekur nga “Sektorë të tjerë rezidentë” me rreth 35.05 për qind. “Korporata private jofinanciare” dhe “Sektorë të tjerë rezidentë” zënë gjithashtu pjesën më të rëndësishme të kredive në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 73.85 për qind dhe rreth 22.91 për qind.



7. Oferta e Parasë

Oferta e parasë (e matur me M3), për muajin shkurt 2016 shënoi rënie me 0.05 për qind krahasuar me muajin paraardhës janar 2016. Kjo ofertë arriti në rreth 223,737.0 milionë lekë në fund të muajit shkurt 2016, duke shënuar një rritje vjetore kundrejt nivelit të regjistruar në muajin shkurt 2015 prej 0.32 për qind.

Fig-11




Raporte të parasë jashtë bankave me M3 dhe Depozitat

Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në lekë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare për muajin shkurt 2016, kanë pësuar rënie prej -16,174.2 milionë lekë në krahasim me muajin shkurt 2015. Depozitat në valutë gjatë muajit shkurt 2016 janë mbështetur kryesisht nga depozitat për individë, të cilat kanë përbërë rreth 84.6 për qind të depozitave në valutë. Ndërsa tek depozitat në lekë, sektori i individëve ka zënë rreth 87.2 për qind të tyre.

Fig-12




Raporti i Depozitave ndaj M3

Burimi: Banka e Shqipërisë

8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit shkurt 2016, zëri “Sektorë të tjerë rezidentë” zuri nivelin më të lartë të depozitave të transferueshme në lekë, me rreth 87.2 për qind, ndjekur nga “Korporata të tjera jofinanciare”, me rreth 9.7 për qind dhe nga “Korporata jofinanciare publike”, me 2.0 për qind. “Sektorë të tjerë rezidentë” dhe “Korporata të tjera jofinanciare” ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 84.6 për qind dhe rreth 13.4 për qind. “Sektorë të tjerë rezidentë” ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 85.9 për qind e totalit.

Fig-13




Rritja e stokut total të depozitave

Burimi: Banka e Shqipërisë

Në total, “Sektorë të tjerë rezidentë” përbëjnë pjesën më të madhe me rreth 843,985.5 milionë lekë të depozitave totale. Ata ndiqen nga “Korporata të tjera jofinanciare” (114,082.2 milionë lekë), “Korporata jofinanciare publike” (14,173.6 milionë lekë) dhe “Korporata të tjera financiare” (8,447.8 milionë lekë). “Qeveria lokale” kontribuoi me rreth 1,782.1 milionë lekë në totalin e depozitave. Gjatë muajit shkurt 2016, niveli i përgjithshëm i depozitave krahasuar me një muaj më parë, shënoi rënie prej -3,872.6 milionë, ndërsa krahasuar me një vit më parë totali i depozitave ka shënuar rritje me 7,587 milionë lekë.

Fig-14



Përberja e depozitave Shkurt 2016

Burimi: Banka e Shqipërisë


Sektori Fiskal

1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën janar-shkurt 2016 janë mbledhur rreth 61.7 miliardë lekë të ardhura, përkundrejt shpenzimeve të përgjithshme prej 51.4 miliardë lekë, ku pjesa më e madhe përfshin 48.5 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe 2.9 miliardë lekë në shpenzime kapitale, nga të cilat 84% janë financime të jashtme.

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Doganave është rreth 41 miliardë lekë (ose rreth 104% e planit të periudhës). Të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor rreth 1.2 miliardë lekë (ose rreth 52% e planit të periudhës). Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 13.6 miliardë lekë (ose rreth 105% e planit të periudhës) dhe të ardhurat jo-tatimore në nivelin 4.3 miliardë lekë (ose rreth 81% e planit të periudhës janar-shkurt).

Nga totali i shpenzimeve korrente prej 48.5 miliardë lekë, 10.9 miliardë lekë (23% e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 6.6 miliardë lekë (14%) për interesat, 3.8 miliardë lekë



(7.7%) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 100 milionë lekë (0.2%) për subvencione, 21.5 miliardë lekë (44%) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe 3.4 miliardë lekë (7%) për shpenzimet e qeverisjes vendore, 2.3 miliardë lekë (5%) për shpenzimet e tjera. Këto përfaqësojnë 15% (shpenzime personeli), 15% (shpenzime për interesat), 9% (shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes), 6% (subvencione), 14% (sigurimet shoqërore dhe shëndetësore), 7% (për shpenzimet e qeverisjes vendore dhe 10% shpenzimet e tjera) përkundrejt planifikimit të tyre vjetor.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm për këtë periudhë ishte 1%, ndërsa financimi i huaj është 9% e planifikimit të tyre vjetor.

2. Të ardhurat sipas burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën janar-shkurt 2016 ishin rreth 61.7 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 55.7 miliardë lekë, të ardhurat jo-tatimore në rreth 4.3 miliardë lekë.

Tab - 2

*Të ardhurat gjatë periudhës janar-shkurt 2016 (mld Lekë)
Revenues during January-February 2016 (in billion ALL)*

Burimi (Source)	shk'16 Feb'16	shk'15 Feb'15	Ndrysh(% Chang (%)
TVSH (VAT)	19.8	18.4	7.6
Tatimi mbi fitimin (Profit Tax)	3.4	2.2	55.5
Taksa doganore (Custom Tax)	0.8	0.7	14.3
Taksat nacionale (National Tax)	5.7	3.7	54.0
Akcizat (Excise)	5.6	4.4	27.3
Tatim mbi të ardhurat personale (TAP) / (Income Tax)	5.7	3.9	46.2

Burimi: Ministria e Financave, Statistikat Fiskale: shkurt – 2016;

Source: Ministry of Finance, Fiscal Statistics: February – 2016;

1. Financimi i Bilancit Fiskal

Suficiti prej 10.3 miliardë lekë, përgjatë periudhës janar-shkurt 2016, u mbështet kryesisht nga huamarrja e brendshme (rreth 37% të totalit të deficitit) dhe nëpërmjet huasë afatgjatë të huaj (rreth 90% të totalit të deficitit).

Për muajin shkurt 2016, disa nga treguesit kryesor fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 34,923 miliardë lekë,

- Realizimi i shpenzimeve në masën 31,856 miliardë lekë.

Në realizimin e të ardhurave për muajin shkurt 2016, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat e mbledhura nga tatimet, të cilat kapin shifrën e 32.5 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 26.8 miliardë lekë dhe shpenzimet kapitale me rreth 5.1 miliardë lekë.

Aneksi Statistikor

Tab - 1																			
Muaji	Mujor (Monthly)						Mesatar Mujor (Monthly Average)						Vjetor (Annual)						Month
	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2011	2012	2013	2014	2015	2016	
Janar	0.8	0.7	1.0	0.8	1.4	0.9	0.80	0.7	1.00	0.8	1.4	0.9	3.3	1.6	2.7	1.7	1.3	1.5	January
Shkurt	2.3	1.3	1.1	1.4	2.4	1.1	1.55	1.0	1.05	1.1	1.9	1.0	4.5	0.6	2.5	1.9	2.3	0.2	February
Mars	-0.1	0.4	0.2	0.5	0.4		1.00	0.8	0.77	0.9	1.4		4.3	1.0	2.4	2.2	2.2		March
Prill	-0.6	-0.1	-0.1	-0.6	-0.5		0.60	0.6	0.55	0.5	0.9		4.1	1.6	2.3	1.7	2.3		April
Maj	-1.1	-0.8	-1.0	-1.1	-1.6		0.26	0.3	0.24	0.2	0.5		4.2	1.9	2.1	1.6	1.8		May
Qershor	-1.1	-0.8	-0.6	-0.7	-1.1		0.04	0.1	0.15	0.1	0.1		3.9	2.2	2.3	1.5	1.4		June
Korrik	-0.7	-0.2	-0.8	-0.6	-0.7		-0.07	0.1	-0.03	0.0	0.3		3.6	2.7	1.6	1.8	1.3		July
Gusht	0.3	0.4	-0.1	0.1	0.8		-0.02	0.1	-0.04	0.0	0.1		3.1	2.8	1.2	2.0	1.9		August
Shtator	0.4	0.2	0.8	0.3	0.6		0.02	0.1	0.06	0.0	0.2		2.8	2.6	1.7	1.5	2.2		September
Tetor	0.4	0.2	0.1	0.1	0.01		0.06	0.1	0.05	0.0	0.3		3.0	2.4	1.7	1.4	2.1		October
Nëntor	0.1	0.2	-0.5	-0.2	-0.3		0.06	0.1	0.01	0.0	0.1		2.9	2.5	1.0	1.7	2.1		November
Dhjetor	1.0	0.9	1.7	0.7	0.6		0.14	0.2	0.15	0.1	0.17		1.7	2.4	1.9	0.7	2.0		December

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë

Source : INSTAT, Bank of Albania

Tab - 2 Kursi i këmbimit
Exchange rate

Monedha	2011	2012	2013	2014	2015	2016		Currency
						Janar	Shkurt	
<i>Mesatarja e periudhës</i>								<i>Average of period</i>
USD	100.90	108.18	105.67	113.64	126.64	127.37	124.70	USD
EURO	140.33	139.04	140.27	140.11	137.65	138.35	138.33	EURO
<i>Fundi i periudhës</i>								<i>In the end of period</i>
USD	107.54	105.85	101.86	115.23	125.79	127.06	126.59	USD
EURO	138.93	139.59	140.20	140.14	137.28	138.68	138.24	EURO

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 3 Normat e interesit me bazë vjetore (në Lek)
Annual Interest Rates (in ALL)

Në përqindje	2011	2012	2013	2014	2015	2016		In percent
						Janar Jan	Shkurt Feb	
Norma e depozitave								Deposits rates
12-M	5.87	5.38	4.17	1.51	1.27	1.18	1.15	12-M
6-M	4.87	4.50	3.40	1.16	1.17	0.90	0.74	6-M
3-M	4.22	3.83	2.72	0.83	0.54	0.50	0.51	3-M
1-M	4.39	3.62	2.79	1.47	0.88	1.14	0.56	1-M
Norma e huasë								Lending rates
12-M	11.17	10.28	9.52	7.00	7.47	8.29	7.31	12-M
6-M	12.28	10.61	9.59	8.18	8.35	9.24	9.48	6-M
Norma e letrave me vlerë								Securities rates
Bono thesari 1/								Treasury bills 1/
3-M	5.31	5.03	3.40	3.15	-	1.45	-	3-M
6-M	6.23	5.65	3.54	3.16	2.46	1.99	1.36	6-M
12-M	6.95	6.37	3.66	3.33	2.40	2.10	1.78	12-M

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 4 TREQESIT FISKALË SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2016
Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2016

		<i>në milionë Lekë (in million ALL)</i>		
<i>Të dhëna progresive (Progressive Data)</i>				
Nr.	E M E R T I M I	Janar January	Shkurt February	
			ITEMS	
	TOTALI TË ARDHURAVE	32,626	61,682	TOTAL REVENUE
I.	Të ardhura nga ndihmat	335	1,655	Grants
II.	Të ardhura tatimore	29,543	55,743	Tax Revenue
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	21,137	40,990	From tax offices and customs
1	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	10,069	19,807	V.A. T
2	Tatimi mbi Fitimin	1,477	3,439	Profit Tax
3	Akcizat	2,789	5,561	Excise Tax
4	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	3,218	5,663	Personal Income Tax
5	Taksa Nacionale dhe të tjera	3,187	5,712	National Taxes and others
6	Taksa Doganore	398	808	Customs Duties
II.2	Të ardhura nga Puahteti Vendor	643	1,202	Revenues from Local Gov.
1	Taksë mbi Pasurinë (ndërtesat)	193	351	Property Tax
2	Taksë mbi Biznesin e vogël	74	170	Small Business Tax
3	Taksa Lokale	376	681	Local Taxes
II.3	Të ardh nga fondet speciale	7,762	13,551	Social ins. contributions
1	Sigurimi Shoqëror	7,031	10,755	Social Insurance
2	Sigurimi Shëndetsor	625	2,480	Health insurance
3	Të ardhura për kompensim në vlerë të pronarëve	106	316	Revenues for property compensation
III.	Të ardhura Jotatimore	2,648	4,284	Non-tax Revenue
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë	0		Profit transfer from BOA
2	Të ardhura nga Inst.Buxhetore	2,005	3,115	Income of budgetary institutions
3	Dividenti	0	2	Divident
4	Tarifat shërbimeve	471	596	Tariffs on services
5	Të tjera	172	571	Other/not allocated
	TOTALI I SHPENZIMEVE	23,710	51,424	TOTAL EXPENDITURE
I.	Shpenzime Korrente	22,489	48,531	Current Expenditures
I.1	Personel	5,430	10,918	Personnel expenditures
1	Paga	4,657	9,376	Wages
2	Kontributi për Sigurime Shoqërore	773	1,542	Social insurance contributions
I.2	Interesat	3,305	6,578	Interest
1	Të Brendshme	2,481	5,105	Domestic
2	Të Huaja	824	1,471	Foreign
I.3	Shpenzime Operative Mirëmbajtje	1,204	3,752	Operational & Maintenance
I.4	Subveconet	54	100	Subsidies
I.6	Shpenzime për fonde speciale	10,263	21,510	Social insurance outlays
1	Sigurime Shoqërore	8,332	16,643	Social insurance
2	Sigurime Shëndetsore	1,931	4,669	Health insurance
3	Fondi i kompensimit të pronarëve	0	198	Expenditures for Owners Compensation
I.7	Shpenzime për Buxhetin Vendor	1,399	3,365	Local budget expenditure
I.8	Shpenzime të tjera	834	2,310	Other expenditures
1	Pagesa e Papunesisë	41	85	Unemployment insurance benefits
2	Ndihma Ekonomike	801	1,956	Social assistance
5	Kompensimi i ish-të përndjekurve politike	-8	269	Compensation for ex-political prisoners
III	Shpenzime Kapitale	1,221	2,893	Capital expenditures
1	Financimi Brendshëm	46	474	Domestically financing
2	Financimi Huaj	1,175	2,419	Foreign financed
V.	DEFICITI	8,816	10,258	CASH BALANCE
V.1	FINANCIMI DEFICITIT	-8,816	-10,258	CASH BALANCE FINANCING
V.2	Brendshëm	-8,852	-19,483	Domestic
1	Të ardhura nga privatizimi	204	207	Privatization receipts
2	Hua-marrje e brendshme	2,503	3,818	Domestic new borrowing (net)
2.1	Nacionale	2,513	3,835	Other
2.2	Lokale	-10	-16	Foreign
3	Të tjera	-11,559	-23,508	Other
4	Depozitë e Qeverisë në Bankën e Shqipërisë	-499	-14,410	Government deposits into the Central Bank
5	Të tjera	-11,062	-9,099	Other
6	Depozita e ISSH dhe ISKSH	-2,759	-1,391	Deposits of Social and Health insurance
7	Mjete në ruajtje	69	-79	Preservation stock
8	Nën-hua	94	160	On-Loan Principal
9	Detyrim ndaj ISSH	621	1,652	Liabilities to SSI
10	Të tjera (detyrime të përkoreshme)	0	41	Other-Float
V.3	I huaj	36	9,225	Foreign
1	Hua afatgjatë(e marrë)	4,002	2,794	Long-term foreign borrowing (gross)
2	Nga e cila nën-hua	242	418	Subsidiary Loan
3	Ndeshimi i gjendjes së arkës*	-3,161	-2,027	Chang. of stat. Account
4	Ripagesat	-805	-1,584	Repayments
5	Mbështetje Buxhetore	0	10042	Budgetary Support

Burimi : Ministria e Financave

Source : Ministry of Finance

Tab - 5

Tabela e investimeve 2016

Table of investments 2016

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

	Janar January	Shkurt Feb	
Financim i brendshëm	46	474	Domestic financing
<i>Në %</i>	<i>3.77</i>	<i>16.38</i>	<i>In %</i>
Financim i huaj	1,175	2,419	Foreign financing
<i>Në %</i>	<i>96.23</i>	<i>83.62</i>	<i>In %</i>
Totali	1,221	2,893	Total
<i>Në %</i>	<i>100</i>	<i>100</i>	<i>In %</i>

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

Tab - 6 TË ARDHURAT DOGANORE 2016 (CUSTOMS REVENUES 2016)

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million Lek)

	Janar January	Shkurt Feb	
Taksë doganore	398	808	Customs Duties
TVSH	6,039	13,050	V.A.T
Akcizë	2,789	5,561	Excises
Të tjera	160	327	Others
Renta Minerare	160	327	
TOTALI	9,386	19,746	Total

TË ARDHURAT TATIMORE 2015 (TAX REVENUE)

TVSH	4,030	6,757	V.A.T
Akciza	0	0	Excises
Tatim mbi fitimin	1,477	3,439	Profit Tax
Tatimi mbi të ardhurat personale	3,218	5,663	Personal income tax
Taksa nacionale dhe të tjera	3,027	5,385	National taxes
TOTALI	11,751	21,244	Total
TOTALI I PËRGJITHSHËM	21,137	40,990	OVERALL TOTAL

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

DEFICITI DHE FINANCIMI PËR 2016

The Deficit and Its Financing for 2016

Të dhëna progresive (Progressive Data)

Në milionë lekë (In million Leks)

	Janar January	Shkurt Feb	
TË ARDHURAT	32,526	61,682	REVENUE
SHPENZIMET	23,710	51,424	EXPENDITURES
BILANCI FISKAL	8,816	10,258	FISCAL BALANCE
FINANCIMI I BILANCIT FISKAL	-8,816	-10,258	FINANCING
Financimi i brendshëm	-8,852	-19,483	Domestic
a. Bono Thesari Neto	-995	-3,570	Treasury bills
b. Obligacione	3,508	7,405	Bonds
c. <i>Ndryshimi i gjëndjes së arkës</i>	-3,258	-15,801	Chang.of stat. account
Depozita e qeverisë në BSH	-499	-14,410	Deposit of Government in B.O.A
Depozita e ISSH dhe ISKSH	-2,759	-1,391	Deposit of Social & Health Ins.
Mjete në ruajtje	69	-79	Non-budget revenues
Të ardhura nga privatizimi	204	207	Privatization receipts
Të tjera detyrime (të përkohshme)	-8,372	-2,851	Others
Huamarrje Brendshme Vendori	-10	-16	Local Borrowing
Financimi i jashtëm	36	9,225	Foreing
a. Hua afatgjatë	4,002	2,794	Long-term foreign borrowing (gross)
nga e cila: nën-hua	242	418	
b. Ndryshimi I gjëndjes së arkës	-3,161	-2,027	Chang. of stat. Account
Ripagesat	-805	-1,584	Repayments
Mbeshtetje Buxhetore	0	10,042	Budgetary Support

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

BILANCI I PAGESAVE

Balance of payments

Në milion Euro

In millions Euro

	Viti 2013	3M_I 2014	3M_II 2014	3M_III 2014	3M_IV 2014	Viti 2014	3M_I 2015	3M_II 2015	3M_III 2015	3M_IV 2015	
Llogaria korente	-1,026.70	-271.50	-341.00	-313.20	-377.50	-1,303.20	-261.60	-174.40	-327.10	-413.70	Current Account.
Bilanci tregtar	-1,729.30	-426.20	-511.40	-560.70	-638.30	-2,136.60	-488.90	-488.50	-616.00	-705.60	Trade Balance.
Eksporti i mallrave fob	1,731.50	212.40	264.90	228.80	219.20	925.30	172.00	250.50	177.20	171.20	Merchandise Exports. Fob
Importi i mallrave fob	-3,460.80	-638.60	-776.30	-789.50	-857.50	-3,061.90	-660.90	-739.00	-793.20	-876.80	Merchandise Imports. Fob
Bilanci i shërbimeve	8.90	30.00	38.10	97.90	102.40	268.40	94.00	127.90	139.70	141.20	Services Balance.
Shërbimet Kredi	1,655.00	396.40	487.10	610.00	538.00	2,031.50	421.50	455.40	607.90	543.40	Services Credit
Shërbimet Debi	-1,646.10	366.40	449.00	512.10	435.60	1,763.10	305.4	327.50	468.2	402.20	Services Debt
Bilanci i të ardhurave	-8.40	-20.60	-43.30	-48.70	-47.00	-159.60	-47.40	-24.10	-27.30	-50.30	Balance of Incomes
Të ardhurat Kredi	193.30	28.70	25.80	28.30	27.80	110.60	27.20	24.60	30.30	32.00	Income Credit
Të ardhurat Debi	-201.70	-49.30	-69.10	-77.00	-74.80	-270.20	-74.60	-48.70	-57.60	-82.30	Income Debt
Bilanci i transfertave	702.10	145.30	175.60	198.30	205.40	724.60	180.70	210.30	176.50	201.00	Balance of Transfers
Transferta private	681.40	172.60	204.40	230.60	244.20	851.80	211.90	243.30	219.10	247.20	Private Unrequired Transfers
Transferta shtetërore	20.70	-27.30	-28.80	-32.30	-38.80	-127.20	-31.20	-33.00	-42.60	-46.20	Official Unrequired Transfers
Llogaria kapitale	47.70	22.50	22.40	20.70	21.10	86.70	26.00	21.30	45.60	32.80	Capital Account
Llogaria financiare	775.60	-161.90	-184.20	-363.00	-247.20	-956.30	-279.1	-208.1	-426.6	-460.1	Financial Account
Investime direkte	893.10	-168.00	-150.40	-253.50	-229.40	-801.30	-257.70	-211.30	-234.00	-167.70	Direct Investment
Investime portofoli	-103.70	14.50	14.00	-12.40	104.70	120.80	-74.70	-66.80	-11.20	-172.10	Portfolio Investment
Kapitale të tjera	-13.80	-8.40	-47.80	-97.10	-122.50	-275.80	109.20	106.10	-183.20	-120.60	Other Capital
Gabime dhe harresa neto	315.30	49.90	104.20	86.40	70.50	311.00	46.20	-38.80	167.10	89.60	Net errors and omissions
Bilanci i përgjithshëm	111.90	-37.20	-30.20	156.90	-38.70	50.80	55.90	36.10	-1.80	168.80	Overall Balance
						0.00					
Rezervat	-104.40	-40.30	22.50	154.00	-39.00	97.20	111.80	16.20	312.50	169.10	Reserve Assets
Përdor kred & huash nga FMN	-7.80	-3.20	52.80	-2.90	-0.30	46.40	55.90	36.10	-1.80	-0.30	Use of Fund Credit and Loans

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

MJETET VALUTORE NETO

Net Foreign Assets

Në milionë Lekë Fundi i periudhës	2011	2012	2013	2014	2015	2016		Millions of Lek End of Period
						Janar Jan	Shkurt Feb	
Mjetet valutore neto	255,657.9	266,540.0	274,198.1	292,098.3	365,663.3	367,089.2	357,778.4	Net Foreign assets
Pretendime ndaj jorezidentëve	276,475.7	288,142.1	294,111.3	318,940.2	407,654.7	409,046.3	420,591.2	Claims on non-residents
Minus: Detyrime ndaj jorezidentëve	20,817.8	21,602.1	199,13.2	26,841.9	41,991.5	41,957.1	62,812.8	Minus: Liabilities to non-residents
Mjetet e brendshme	84,492.3	78,858.1	67,841.8	82,525.1	63,394	62,282.7	55,537	Domestic Assets
Pretendimet neto ndaj qeverisë qendrore	57,098.0	55,145.6	44,503.1	55,198.3	48,752	48,396.8	44,838	Claims on Central Government
Pretendimet ndaj qeverisë qendrore	67,590.8	68,057.8	66,768.8	71,831.3	75,143.9	75,218.0	85,530.7	Net Claims on Central Government
Minus: Detyrime ndaj qeverisë qendrore	10,492.8	12,912.2	22,265.7	16,633.0	26,391.9	26,821.2	40,692.5	Minus: Due to Central Government
Pretendime ndaj korporatave të tjera depozituese	25,485.8	21,800.8	21,502.9	25,547.8	12,237.0	12,237.0	9,057.2	Claims on other depository corporations
Pretendime ndaj korporatave të tjera financiare	-	-	-	-	-	-	-	Claims on other financial corporations
Pretendime ndaj korporatave jofinanciare publike	-	-	-	-	-	-	-	Claims on public non-financial corporations
Pretendime ndaj korporatave të tjera jofinanciare	-	-	-	37.3	-	-	-	Claims on other non-financial corporations
Pretendime ndaj sektorëve të tjerë rezidentë	1,908.5	1,911.7	1,835.8	1,741.7	1,648.9	1,648.9	1,641.6	Claims on other resident sectors
Baza Monetare	289,809.0	297,721.9	308,073.7	332,899.3	383,972.8	380,683.3	364,045.3	Monetary Base
Depozita të papërfshira në parinë e gjerë	2,432.0	1,125.1	787.9	1,093.8	451.8	175.7	171.1	Deposits not included in broad money
Huatë	-	-	-	-	-	-	-	Loans
Llogari të pagueshme	901.1	1,306.1	1,309.8	14.8	34.2	11.3	10.5	Other accounts payable
Të tjera neto	-12,984.4	-14,702.6	-14,102.8	-15,170.5	-18,792	-18,558.6	-18,540	Other items net
Aksione	59,992.0	59,947.5	45,971.3	55,786.1	63,391.1	67,060.2	67,628.1	Shares and other equity

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 10 **KREDIA PËR EKONOMINË**
Credit to Economy

Në milion Lekë Fundi i periudhës	2011	2012	2013	2014	2015	2016		Million of Lek End of Period
						Janar Jan	Shkurt Feb	
Totali i kredisë	541,899.9	554,732.2	547927.6	559,986.7	546,873	543,213.1	544,355.5	Total Credit
Kredia për qeverinë lokale	147.20	193.9	256	777.7	887.7	880.2	878.5	Credits to local Government
Në Lekë	147.20	193.9	256	777.7	887.7	880.2	878.5	in Lek
Në valutë	-	-	-	-	-	-	-	in Foreign Currency
Kredia për korporatat jofinanciare publike	18,678.5	23,780.7	24961	27,328.1	27,419.7	27,419.6	27,612.1	Credits to Public Non-financial Corporations
Në Lekë	8,446.2	18,474.3	20251.4	22,402.3	22,326.1	22,258.0	22,469.5	in Lek
Në valutë	10,232.3	5,306.4	4709.6	4,925.8	5,093.6	5,161.6	5,142.6	in Foreign Currency
Kredia për korporatat jofinanciare private	364,373.9	370,993.0	363541.2	372,166.5	355,725.2	353,032.2	353,462.9	Credits to other Non-financial Corporations
Në Lekë	108,321.7	121,808.7	122944.7	129,429.4	129,233.7	127,448.2	127,494.4	in Lek
Në valutë	256,052.2	249,184.3	240596.5	242,737.1	226,491.5	225,584.0	225,968.5	in Foreign Currency
Kredia për korporatat e tjera financiare	9,841.9	10,162.9	9578.2	8,270.3	9,537.7	8,434.0	8,763.2	Credits to Other Financial Corporations
Në Lekë	3,364.2	4,031.7	4238.4	3,436.9	5,036.2	3,744.7	3,983.0	in Lek
Në valute	6,477.7	6,131.2	5339.8	4,833.4	4,501.5	4,689.3	4,780.2	in Foreign Currency
Pretendime për sektorë të tjerë rezidentë	148,858.4	149,601.7	149591.2	151,444.1	153,303.1	153,447.1	153,638.8	Claims to other Resident Sectors
Në Lekë	68,499.9	70,614.1	72242.5	77,396.7	83,319.7	83,141.6	83,551.6	in Lek
Në valutë	80,358.5	78,987.6	77348.7	74,047.4	69,983.4	70,305.5	70,087.2	in Foreign Currency

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 11 **OFERTA E PARASË**
Money Supply

Mujor-Monthly

Në milion Lekë Fundi i periudhës	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016		Millions of LEK End of Period
							Janar Jan	Shkurt Feb	
Baza monetare	283,453.5	289,809.5	297,721.9	308,073.7	332,899.3	383,972.8	380,683.3	364,045.3	Base Money
Ndryshimi vjetor në %	-0.5	5.4	2.7	3.5	8.1	15.3	1.1	1.1	Y/Y change in %
Paraja jashtë korporatave depozituese	195,059.0	194,923.4	192,705.1	198,892.7	217,665.6	239,218.1	235,588.8	234,131.6	Currency Outside Depository
Ndryshimi vjetor në %	-6.7	-0.1	-1.1	3.2	9.4	9.9	9.6	7.8	Y/Y change in %
Depozita	785,225	875,230	930,703	950,088.4	977,420	687,292.6	682,971.9	682,220.8	Deposits
Ndryshimi vjetor në %	18.5	10.5	6.3	2.1	2.9	-27.7	-28.1	-28.2	Y/Y change in %
Agregati M1	275,427.3	276,898.3	281,246.6	295,876.5	353,321.7	384,106.9	374,876.5	375,147.8	M1 Aggregate
Ndryshimi vjetor në %	-3.2	0.5	1.6	5.2	19.4	8.7	8.3	7.3	Y/Y change in %
Agregati M2	604,517.3	647,007.8	669,577.1	693,172.2	722,356.7	723,975.7	712,512.5	708,255.5	M2 Aggregate
Ndryshimi vjetor në %	4.6	7.0	3.5	3.5	4.2	0.2	-0.3	-1.4	Y/Y change in %
Agregati M3	980,283.9	1,070,153.7	1,123,407.8	1,148,980.9	1,195,086.3	1,218,101.2	1,211,534.4	1,206,208.0	M3 Aggregate
Ndryshimi vjetor në %	12.5	9.2	5.0	2.3	4.0	1.9	2.0	1.2	Y/Y change in %
Burimet e bazës monetare									Monetary Base sources
Mjetet e huaja neto	252,827.8	255,657.9	266,540.0	274,198.1	292,098.3	365,663.3	367,089.2	357,778.4	Net foreign assets
Mjetet e brendshme neto	72,244.3	84,492.3	78,858.1	67,841.8	82,525.1	63,394.2	62,282.7	55,537.0	Domestic assets
Pretendimet ndaj qeverisë qendrore neto	57,937.1	57,098.1	55,145.6	44,503.1	55,198.3	48,752.0	48,396.8	44,838.2	Net Claims on central government
Pretendimet ndaj korporatave të tjera depozituese	12,535.6	25,485.8	21,800.8	21,502.9	25,547.8	12,987.1	12,237.0	9,057.2	Claims on other depository corporations

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 12 DEPOZITAT
Deposits

Mujor-Monthly

Në milionë Lekë Fundi i periudhës	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016		Millions of Leks End of Period
							Janar Jan	Shkurt Feb	
Në lekë	409,459	452,085	476,872	494,279.5	504,691	493,374	487,091	484,519	In national currency
Depozitat e transfer + D. me likuiditet të lartë	80,369	81,975	88,541	96,983.9	135,656	153,506	149,455	151,411	Transferable deposits+Liquid deposits
Qeveria lokale	948.1	1,157.4	1,059.7	1,305.0	2,047.5	1,473.8	1,530.5	1,488.6	Local governments
Korporata jofinanciare publike	7,134.0	7,303.4	7,168.0	6,108.2	9,799.5	8,736.2	7,847.6	8,641.6	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	920.6	532.5	1,789.2	937.0	1,919.8	1,258.9	1,439.3	1,431.9	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	22,505.0	20,681.5	24,716.6	24,244.0	38,198.6	40,993.6	35,767.0	35,096.9	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	48,860.8	52,300.1	53,807.9	64,389.7	83,690.6	101,043.0	102,870.4	104,751.8	Other resident sectors
Depozita të tjera	329,090	370,110	388,331	397,295.6	369,035	339,869	337,636	333,108	Other deposits
Qeveria lokale	55.1	109.6	19.4	57.1	7.8	29.9	19.3	19.4	Local governments
Korporata jofinanciare publike	3,054.3	2,608.9	1,715.4	1,257.8	1,167.9	815.0	850.0	910.5	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	1,773.4	1,423.5	2,224.4	2,556.5	1,730.1	3,573.4	3,221.7	2,118.4	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	8,316.8	11,292.5	10,954.1	14,523.4	11,772.0	11,292.1	12,324.0	12,080.1	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	315,890.5	354,675.1	373,417.3	378,900.8	354,357.3	324,158.3	321,221.0	317,979.4	Other resident sectors
Në valutë	375,767	423,146	453,831	455,808.9	472,729	193,918	195,881	197,702	In foreign currency
Qeveria lokale	493.0	280.5	44.5	372.6	231.3	209.5	249.0	274.1	Local governments
Korporata jofinanciare publike	6,201.0	5,242.2	4,011.2	4,486.2	7,099.6	3,645.4	2,653.7	2,662.9	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	8,572.0	6,022.3	6,303.3	6,673.1	4,872.9	2,641.2	1,256.1	1,598.9	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	57,382.9	54,418.4	46,867.5	49,382.3	55,834.3	53,618.9	52,541.6	52,759.0	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	303,117.7	357,182.4	396,604.2	394,894.7	404,691.2	133,803.4	139,180.7	140,407.3	Other resident sectors
Totali	785,225	875,230	930,703	950,088.4	977,420	687,293	682,972	682,221	Total
Qeveria lokale	1,496.2	1,547.5	1,123.6	1,735	2,286.6	1,713.2	1,798.8	1,782.1	Local governments
Korporata jofinanciare publike	16,389.3	15,154.5	12,894.6	11,852.2	18,067.0	13,196.6	11,351.3	12,215.0	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	11,266.0	7,978.3	10,316.9	10,166.6	8,522.8	7,473.5	5,917.1	5,149.2	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	88,204.7	86,392.4	82,538.2	88,149.7	105,804.9	105,904.6	100,632.6	99,936.0	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	667,869.0	764,157.6	823,829.4	838,185.2	842,739.1	559,004.7	563,272.1	563,138.5	Other resident sectors

Burimi : Banka e Shqiperisë

Source : Bank of Albania

BILANCI I PËRMBLEDHUR I BSH

Consolidated BoA Balance sheet

Në milion Lekë Fundi i periudhës	2011	2012	2013	2014	2015	2016		Millions of Lek End of period
						Janar Jan	Shkurt Feb	
AKTIVET	384,581	394,834	398,814	433,878	516,358	516,804	535,439	
Total	48,572	48,288	40,652	51,880	126,386	120,762	119,163	Total
Mbajtjet e SDR	8,226.5	8,789.7	10,508.0	19,299.7	30,578.8	31,022	28,058.6	SDR holdings
Arka në valutë	59.8	67.5	57.3	56.2	84.9	24.9	24.6	Foreign currency
Depozitat	40,286	39,431.1	30,086.2	32,524.0	95,722.4	89,715.1	91,080.2	Deposits
Letrat me vlerë të ndryshme nga aksionet	284,210	294,007	308,387	320,745	323,679	330,930	330,093	Securities other than shares
Jorezident	219,718.8	229,313.1	243,178.6	256,796.7	270,453.6	277,674	276,817.2	nonresidents
Qeveria qendrore	64,490.8	64,694.1	65,208.4	63,947.9	53,225.5	53,256.1	53,276.1	central government
Huatë	27,388	23,707	23,333	27,286	14,641	13,885	10,697	Loans
Qeveria qendrore	-	-	-	-	-	-	-	Central Government
Korporata të tjera depozituese	25,485.4	21,800.2	21,502.3	25,547.8	12,987.1	12,237	9,057.2	Other depository corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	1,902.8	1,906.5	1,830.9	1,738.5	1,654.0	1,647.5	1,640.1	Other resident secotrs
Derivatet financiare	35.3	14.2	31.5	17.4	27.7	17.0	25.0	Financial derivatives
Llogari të arketueshme	11,295.9	14,129.2	11,994.1	18,197.8	32,741.6	32,812.4	57,096.2	Receivable accounts
Mjetet jofinanciare	13,080.0	14,688.0	14,416.4	15,752.1	18,882.5	18,398.5	18,363.5	Nonfinancial assets
DETYRIMET	384,581	394,834	398,814	433,878	516,358	516,795	535,430	LIABILITIES
Total	203,009	201,086	208,042	226,588	241,006	237,031	234,447	Total
Para në qarkullim	202,906.6	200,898.7	207,792.7	226,434.1	239,218.1	235,589	234,131.6	Currency in Circulation
Depozitat e përfshira në paranë e gjerë	102.8	187.3	249.7	154.2	1,787.9	1,442.4	314.9	Deposits included in broad money
Depozita të papërfshira në paranë e gjerë	108,017	120,691	132,765	140,569	201,586	202,351	222,824	Deposits excluded from broad money
Jorezident	8,318.7	10,042.9	9,706.5	16,564.1	31,826.2	31,755	52,414.9	Nonresidents
Qeveria qendrore	10,465.6	12,887.1	22,239.2	16,600.5	26,340.8	26,769	40,647.9	Central government
Korporata të tjera depozituese	88,570.2	97,054.7	100,031.3	106,310.9	142,966.8	143,652	129,589.7	Other depository corporations
Korporata të tjera jofinanciare	20.5	37.2	62.5	85.0	87.4	88	87.6	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	641.5	669.2	725.4	1,008.8	364.4	88	83.5	
Huatë	4,852	3,871	2,919	2,294	1,810	1,785	1,689	-
Jorezidentët	4,852.0	3,870.7	2,919.3	2,294.2	1,809.6	1,785	1,688.7	Nonresidents
Qeveria qendrore	-	-	-	-	-	-	-	Central Government
Korporata të tjera depozituese	-	-	-	-	-	-	-	Other depository corporations
Llogari të pagueshme	1,064.3	1,680.5	1,828.3	886.8	461.1	408	677.9	Other accounts payable
Alokimi i SDR	7,647.1	7,557.9	7,287.5	7,753.2	8,104.4	8,160	8,164.9	SDR allocation
Aksione dhe instrumenta të tjerë	59,992	59,947.5	45,971.3	55,786.1	63,391.1	67,060	67,628.1	Shares and other equity

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania